VENDIM
Nr. 87, datë 30.3.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 59, SERIA NPM08P, DHËNË SHOQËRISË "ERS-08" SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 63, DATË 13.6.2008, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 7, 8 dhe 9, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/4 prot., datë 24.3.2021 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 33, datë 4.2.2021, vendosi:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë "ERS-08" sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 63, datë 13.6.2008, i ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë "ERS-08" sh.p.k., nr. 59, seria NPM08P.

3. Shoqëria "ERS-08" sh.p.k. ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimmarrje të Bordit nëpërmjet shkresës nr. 306, datë 11.2.2021, përmes së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.

- Nuk rezulton që shkresa e dërguar të jetë kthyer mbrapsht nga posta, ndaj konsiderohet se shoqëria ka marrë dijeni për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar prej 30 ditësh nga marrja dijeni, shoqëria "ERS-08" sh.p.k., nuk ka depozituar në ERE as informacion dhe as dokumentacion dhe nuk ka marrë masa për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa "c", të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e kësaj licence, shoqëria "ERS-08" sh.p.k., nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe ajo nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 59, seria NPM08, dhënë shoqërisë "ERS-08" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 13.6.2008, i ndryshuar.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "ERS-08" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti